



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:177020  
Datë: 23.05.2024  
Numri i dokumentit: 05723188

Ac.nr.2154/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.S nga P.....të cilin sipas autorizimit e përfaqëson I.G avokat në Prishtinë, kundër të paditurës KRU “P.....” Sh.a, me seli në P....., për kompensim të pagave jubilarë dhe përcjellëse, duke vendosur sipas ankesës së paditësit e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.5415/2020, i datës 16.02.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 22.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit S.S nga P....., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.5415/2020, i datës 16.02.2022, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar numër, C.nr.5415/2020, i datës 16.02.2022, ka vendosur: *“I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit S.S nga P....., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura KRU “P.....” Sh.a, që paditësit, në emër të shpërblimit jubilar, t’ia paguaj tri (3) paga mujore në shumën prej 1,800.00 € si dhe në emër të një (1) page përcjellëse me rastin e pensionimit shumën prej 600.00 €, gjithsej shumën e borxhit prej 2,400.00 € me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e ushtrimit të padisë, deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.*

## *II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore”.*

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, përmes të autorizuarit të tij, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë si të bazuar ankesën e paditëses dhe aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit.

Ankesa e paditësit i është dorëzuar të paditurës për përgjigje, por e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e paditësit është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me datë 15.12.2020, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi kundër të paditurës, duke kërkuar të aprovohet si e bazuar kërkesëpadija e paditëses dhe të detyrohet e paditura që paditësit ti paguaj në emër të tri pagave jubilarë dhe përcjellëse në shumën e tërësishme prej 2.400€ dhe atë me kamatë prej 8% nga dita e parashtrimit të kërkesës së dt.13.02.2020 e deri në pagimin definitiv, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës në kuptim të nenit 398 të LPK-së, jashtë seance ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.5415/20, të datës 16.02.2022, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese fakti se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën dhe atë nga data 24.05.1971 dhe se paditësi ka dalur në pension me datë 20.06.2018, fakt ky që konstatohet edhe nga Aktvendimi nr.1727/206-4 i datës 01.06.2018 lëshuar nga e paditura. Meqenëse paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën me datë 24.05.1971 dhe atë në kohë të pacaktuar, gjykata ka vlerësuar se i njëjti ka arritur tridhjetë (30) vite përvojë pune, respektivisht katër dhjetë (40) vite tek e paditura para hyrjes në fuqi të MPKK-së, sepse nga koha e themelimit të marrëdhënies së punës e deri në hyrjen në fuqi të MPPK-së, kanë kaluar mbi katërdhjetë vite. Në këtë drejtim, gjykata gjen se e drejta e paditësit për të kërkuar shpërblimin jubilar në emër të 30 viteve përvojë pune ka lindur nga hyrja në fuqi e MPPK-së, me datë 01.01.2015, me afat për realizimin e kësaj të drejte deri më 31.12.2017. Meqenëse paditësi i është drejtuar gjykatës për realizimin e shpërblimit jubilar me 15 dhjetor 2020, atëherë del që kërkesëpadija në raport me shpërblimin jubilar nuk gjen mbështetje në MPKK, pasi në kohën e paraqitjes së padisë, nuk ka ekzistuar bazë juridike për njohën e këtyre shpërblimeve. Sa i përket pjesës së kërkesëpadiës që i referohet kompensimit të pagave përcjellëse për shkak të daljes në pension, Gjykata gjen se

paditësi, ka arritur moshën e pensionimit me datë 20.06.2018, kohë kjo kur MPPK ka qenë jashtë fuqisë, ndërsa padinë për realizimin e kësaj të drejte e ka paraqitur pas skadimit të MPPK-së, pra me datë 15.12.2020. Andaj, Gjykata vlerëson se paditësi kërkesën e bazon në një periudhë kur nuk ka pasur bazë ligjore për një kompensim të tillë, ngase MPPK në fjalë nuk mund të aplikohet dhe të paraqet bazë juridike për kërkesëpadinë e paditësit as në raport me pagat përcjellëse. Kjo pasi që e paditura, nuk ka marrë obligime përtej periudhës kohore sa Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka qenë në fuqi. Andaj gjykata vendosi që kërkesëpadinë e paditësit në mungesë të dispozitave ligjore dhe marrëveshjes kolektive për paga jubilarë, për realizimin e kësaj të drejte, ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, ndërsa për shpenzimet e procedurës është mbështetur në dispozitën e nenit 452.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, e aprovon vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësoretë dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së dhe as në shkelje tjera të pretenduara nga pala ankuese dhe se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht si dhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare dhe ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pathemeltë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata ka arsyetuar faktin se paditësi përvojën e punës prej 30 viteve e ka arritur në vitin 2001 dhe se paditësi ka dalur në pension me datë 20.06.2018 dhe se kjo rrethanë nuk ka qenë kontestuese as nga e paditura, andaj në raport me këtë arsyetimi është sipas kërkesave ligjore.

Sa i përket pretendimeve se palës paditëse i takon një e drejtë nuk qëndron për faktin se nga shkresat e lëndës rezulton se pala paditëse vitin jubilar e ka arritur në vitin 2001 ndërsa pagën përcjellëse në vitin 2018 në kohën kur nuk ka qenë në fuqi asnjë marrëveshje kolektive, pasi që është Ligji i Punës është ai i cili përcakton në mënyrë strikte afatin 3 vjeçar të kohëzgjatjes së kontratës kolektive, pastaj është edhe praktika gjyqësore dhe Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme ai i cili konfirmon faktin se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka validitet 3 vjeçar që nënkupton nga data 01.01.2015 deri me 31.12.2017.

Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, për shkak të mungesës së bazës ligjore për realizimin e një kërkesë të tillë, sepse parashkrimi si prapësim merret në konsideratë kur ekziston baza por padia nuk është bërë brenda kohës, ndërsa këtu padia është parashtruar për një kërkesë e cila është e pa bazë, nga

shkaku se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, ka hyrë në fuqi prej dt. 01.01.2015, ndërsa paditësi vitin jubilar e ka arritur para se të hyjë në fuqi marrëveshja në fjalë ndërsa pagën përcjellëse pas skadimit të kësaj kontrate, e cila nuk ka veprim retroaktiv, por vlen për kërkesat që paraqiten, për palët që e kanë arritur jubilaritetin brenda kohëzgjatjes së marrëveshjes.

Gjykata e Apelit gjen se dispozitat e përkatëse të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, gjegjësisht neni 52 dhe 53, me të cilat përcaktohet e drejta e punëtorit në shpërblim jubilar me rastin e arritjes së përvojës së punës dhe e drejta e kompensimit në emër të pagave përcjellëse për shkak të pensionimit nuk gjejnë zbatim në rastin konkret, sepse në raport me shpërblimin jubilar, paditësi është dashur që padinë ta paraqes brenda kohës së vlefshmërisë së MPKK, ndërsa sa i përket pagave përcjellëse Gjykata gjeti se në kohën e pensionimit të paditësit, MPKK nuk ka qenë e aplikueshme, dhe se kjo Marrëveshje nuk ka marrë obligime përtej periudhës sa ka qenë në fuqi.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera nga ankesa, por të njëjtat ishin pa ndonjë ndikim në një vendosje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për shkak se jubilariteti nëse është arritur para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje, nuk mund të kërkohej më një marrëveshje e cila ka hyrë 3 vite më vonë, e që këtë edhe Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme dhe se tani praktika gjyqësore është e qartë, nuk ka validitet Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive para datës 01.01.2015 dhe pas datës 31.12.2017.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2154/2022, me datë 22.05.2024

Kryetarja e kolegjit  
Nora Bllaca-Dula, d.v